

Because life matters most.

further



International
Healthcare
Programme



PROGRAMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR
NDËRKOMBËTAR

PYETJET MË TË SHPESHTA

DOKUMENT INFORMUES

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Pyetjet më të shpeshta

Mohimi i përgjegjësive - Për informacione më të detajuara në lidhje me Programin e Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar, referojuni Udhëzuesit. Për të mësuar më shumë për sëmundjet që mbuloohen nga Programi, ju lutemi [klikoni këtu](#).

Cili është ndryshimi mes këtij Programi të Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar dhe llojeve të tjera të sigurimeve (sigurimi i shëndetit, sigurimi i jetës, sigurimi për sëmundje të rëndë)?

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar (Programi) ofron akses te specialist ekspert dhe trajtime në qendra mjekësore jashtë shtetit tuaj të banimit/punësimi. Agjencia Further kujdeset për çdo gjë që kërkohet nga Anëtari i siguruar për të marrë trajtimin jashtë shtetit ku ai banon/punon, që zakonisht përfshin: kërkimin për specialistin dhe qendrën më të mirë mjekësore; organizimin e vizitave mjekësore; koordinimin e logjistikës për udhëtimin si p.sh. transporti dhe strehimi; si dhe administrimin e faturave drejtpërdrejt me qendrën mjekësore.

Pse Anëtari i siguruar mund të ketë nevojë për politikën e Programit të Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar?

Trajtimi për Sëmundjet dhe procedurat mjekësore të mbuluara nga kjo Politikë mund të jenë shumë të kushtueshme nëse Anëtari i siguruar kërkon një trajtim me specialistin/qendrën më të mirë të kujdesit shëndetësor ndërkombëtar jashtë shtetit ku ai banon/punon. Në rast se Anëtari i siguruar kërkon një trajtim për çdo Sëmundje ose procedurë mjekësore të mbuluar, ai/ajo mund të arrijë të marrë në konsideratë vetëm opsionet brenda mundësive të veta ekonomike. Ky Program e zgjeron këtë mundësi duke ofruar akses për kujdesin dhe trajtimin më të mirë mjekësor ndërkombëtar.

Cila është vlera e Programit për punonjësit?

Vlera kryesore e këtij Programi është të keni akses në kujdesin dhe trajtimin më të mirë shëndetësor ndërkombëtar në rast të një sëmundjeje të rëndë, si dhe të sigurojë që të gjitha çështjet operative, kostot e udhëtimit dhe shpenzimet e strehimit janë të mbuluara paraprakisht për ju dhe një shoqëruar.

Kush mund të bëhet pjesë e Programit?

Të gjithë punonjësit, në një marrëdhënie punësimi me kohë të pacaktuar me një nga shoqëritë e Intesa Sanpaolo të mbuluara nga ky Program.

Si është e mundur që specialisti të japë një opinion të dytë mjekësor pa e shikuar pacientin?

Informacionet mjekësore dhe rezultatet e testeve analizohen sipas kërkesës së ekipit mjekësor të Programit, detyra e të cilëve është të verifikojnë që këto janë të përshtatshme dhe kanë detaje të mjaftueshme që specialisti të mund t'i analizojë pa qenë e nevojshme të shikojnë Anëtarin e siguruar.

Because life matters most.

further



International
Healthcare
Programme

FAQJA 1

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Nëse specialisti im është jashtë shtetit, si do të komunikojmë?

Anëtari i siguruar nuk ka nevojë të komunikojë drejtpërdrejt me specialistin ndërkombëtar. Ekipi i Programit kujdeset për çdo gjë të nevojshme për procesin e marrjes së opinionit të dytë mjekësor. Pika kryesore e kontaktit për Anëtarin e siguruar do të jetë Menaxheri i çështjes i caktuar për çështjen në fjalë. Ai ose ajo do të shpjegojë hapat e ndryshëm që përfshihen në proces si dhe rezultatet nga raporti i Best Doctors[®] InterConsultation[®], i cili do të përkthehet në gjuhën tuaj.

Sa kohë do të duhet që Programi të japë një opinion të dytë mjekësor për pacientin?

Koha maksimale e përgjigjes për vlerësimin e informacioneve mjekësore të disponueshme dhe dorëzimin e raportit të opinionit të dytë nga specialisti është 10-15 ditë pune pas marrjes së të dhënave mjekësore të anëtarit.

Si e zgjedh ekipi i Programit specialistin më të përshtatshëm për të analizuar çdo çështje?

Programi punon me një bazë të dhënash me më shumë se 50 000 specialistë ndërkombëtarë, të cilët konsiderohen si ekspertët më të mirët në specialitetin e tyre, nga kolegët e tyre në profesion. Analiza e detajuar e informacioneve mjekësore të disponueshme i lejon ata që të përcaktojnë specialistin më të përshtatshëm për çdo rast, sipas ekspertizës dhe eksperiencës së tij/saj profesionale.

Specialistët zgjidhen nëpërmjet një metodologjie për vlerësimin e vazhdueshëm nga kolegët, që bën të mundur që Best Doctors të krijojë një rrjet unik dhe të respektojnë me specialistët që njihen në nivel ndërkombëtar si më të mirët në fushën e tyre.

Gjatë procesit të InterConsultation®, a do të kryejë Anëtari i siguruar një konsultë individuale me specialistin ndërkombëtar?

Procesi i InterConsultation® nuk përfshin konsulta individuale me specialistin e rekomanduar para fillimit të trajtimit. Eksperiencia e suksesshme e agjencisë Further me zgjidhjet e Best Doctors është garancia më e mirë kur është fjala për të zgjedhur specialistin më të përshtatshëm për çdo rast.

Si përcaktohet opsioni më i përshtatshëm për trajtimin jashtë shtetit?

Eksperiencia e gjerë e agjencisë Further si një ofruar i shërbimeve mjekësore i lejon ata të identifikojnë specialistët dhe qendrat mjekësore më të mira ndërkombëtare. Further do të ofrojë minimumi 3 opsione për marrjen e trajtimit të rekomanduar nga specialisti ndërkombëtar, si dhe do t'ju ndihmojë të zgjidhni opsionin më të përshtatshëm.

Nëse një Anëtar i siguruar është diagnostikuar me një sëmundje të rëndë, si do ta dijë ai ose ajo se cili është opsioni më i mirë për të marrë një trajtim jashtë shtetit?

Kur një Anëtar i siguruar që përballet me një sëmundje të rëndë kontakton me [qendrën tonë telefonike](#), hapi i parë është të kryejë shërbimin e InterConsultation®, shërbimi i opinionit të dytë mjekësor të specialistit që ofrohet nga Programi.

Specialisti ndërkombëtar i zgjedhur për të rishikuar dhe konfirmuar diagnozën do të rekomandojë trajtimin më të përshtatshëm.

Më pas Further i ofron Anëtarit të siguruar qendra të ndryshme ndërkombëtare jashtë shtetit ku banon/punon, të cilat konsiderohen se janë opsionet më të mira për të marrë trajtimin e rekomanduar.

Because life matters most.

further



International
Healthcare
Programme

FAQJA 2

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Nëse specialisti ndodhet në shtetin ku banon/punon Anëtari i siguar, a do të mund ta marrë ai/ajo trajtimin në vend?

Jo, Programi mbulon ekskluzivisht trajtimin jashtë shtetit të banimit/punësimit.

A janë shumat e siguruara të mjaftueshme për trajtimin jashtë shtetit?

Ky sigurim është hartuar në mënyrë të tillë, për të siguar trajtimin në qendra ndërkombëtare prestigjioze, pa rrezikuar cilësinë. Shumat bazohen në eksperiencën e gjerë të agjencisë Further si një ofrues i shërbimeve mjekësore dhe ekspertizës në sektorin e sigurimeve.

Po nëse kërkohet një vizë për të udhëtuar në një shtet tjetër, a do të ofrojë mbështetje agjencia Further?

Po, Menaxheri i çështjes “Case Manager” do ta drejtojë Anëtarin e siguar te një organizatë që mund t’ju ofrojë të gjithë ndihmën e nevojshme për të organizuar marrjen e një vize. Programi do të mbulojë të gjitha kostot e përfshira. Në rast se nuk mund të merret një vizë për një destinacion të veçantë, do të ofrohen opsione të tjera.

Çfarë do të ndodhë nëse do të jenë të nevojshme një trajtim vijues ose trajtime mjekësore shtesë?

Trajtimet vijuese ose shtesë mund të organizohen, me kusht që trajtimet të mbulohen nga Programi dhe që të jenë brenda limiteve të përcaktuara:

- 500 000 EURO / sigurimi në vit për Anëtar të siguar; dhe
- 1 000 000 EURO / limiti për të gjithë jetën (duke supozuar që politika është rinovuar).
Nuk ka asnjë limit për numrin e trajtimeve të marra, dhe as për numrin e ditëve të kaluara në spital.

Në rast të transplantëve të organeve, a mund të ndihmojë Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar për prioritetin për pacientët e tyre në listën e pritjes për marrësit e organeve?

Duhet të keni parasysh se vetëm transplantet nga dhurues të gjallë mbulohen nga Politika.

Në lidhje me transplantet e palcës së kockës, ka një bazë të dhënash nga e gjithë bota me dhurues të mundshëm të testuar.

Në rast të transplantëve të veshkës, lobit pulmonar, një pjesë të mëlçisë ose të pankreasit, skenari më i mundshëm është që dhuruesit të jenë familjarë të afërm të marrësit të organit, për shkak të përputhshmërisë së kërkuar gjenetike dhe histologjike që rrit probabilitetin për pranimin e organit.

Në çdo rast, Menaxheri i çështjes “Case Manager” do të ndihmojë në procesin e testimit dhe hetimit për dhurues të mundshëm.

Because life matters most.

further



FAQJA 3

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Pse transplantet e dhuruesve të organeve nga kufomat nuk mbulohen nga Programi?

Ka një arsye shumë të fortë për këtë kufizim. Ofrimi i organeve nga dhurues të vdekur në mënyrë private në Evropë është gjerësisht i ndaluar dhe mund të kryhet vetëm nëpërmjet sistemit publik të kujdesit shëndetësor, ndërsa në SHBA kërkohet që të jeni një banor në Shtetet e Bashkuara për më shumë se dy vjet si dhe disponueshmëria e menjëhershme e marrësit. Në këto rrethana, nuk është e mundur që të ofrohet mbulimi i plotë sipas politikës.

A mbulohen protezat?

Çdo lloj proteze ose pajisjeje ortopedike, korse, fashatime, paterica, pjesë ose organe artificiale, paruke (edhe kur përdorimi i tyre konsiderohet i nevojshëm gjatë trajtimit me kimioterapi), këpucë ortopedike, struktura mbështetëse dhe pajisje ose artikuj të tjerë të ngjashëm, nuk mbulohen nga Programi. Po nëse kërkohet një vizë për të udhëtuar në një shtet tjetër, a do të ofrojë mbështetje agjencia Further? Kini parasysh sidoqoftë se protezat e gjoksit, si rezultat i kirurgjisë së mastektomisë, dhe valvulat proteza të zemrës mbulohen në fakt nga Politika, por vetëm kur nevojiten si rezultat i kirurgjisë së organizuar dhe të paguar sipas këtij Programi.

Çfarë konsiderohet një protezë në këtë Program?

Përkufizimi i protezës, siç përfshihet në kushtet tona të politikës, i referohet çdo pajisje që zëvendëson një pjesë ose të gjithë organin ose zëvendëson një pjesë ose të gjithë funksionin e një pjese trupore që nuk vepron ose funksionon.

A konsiderohen proteza elementet e futura të kockave ose elementet e futura të indeve të lëkurës/muskujve?

Jo, ato nuk mund të konsiderohen proteza bazuar në përkufizimin tonë të miratuar dhe nuk do të mbulohen.

Në rast se nevojitet një operacion kirurgjikal për zëvendësimin e valvulës së zemrës, a mbulohet kostoja e protezës së valvulës së zemrës?

Po. Si rregull i përgjithshëm, kostoja e protezës nuk mbulohet nga politika, por proteza e valvulës së zemrës mbulohet në procedurën mjekësore të zëvendësimit të valvulës së zemrës që përmendet në kushtet e politikës.

Because life matters most.

further



FAQJA 4

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

Pas marrjes së trajtimit jashtë shtetit të banimit/punësimit, a mbulohet kostoja e produkteve dhe barnave farmaceutike në kujdesin e mëpasshëm ose trajtimin pas operacionit në lidhje me sëmundjen, në rast se blihen në shtetin e banimit/punësimit?

Po, barnat e blera në shtetin e banimit/punësimit, të cilat janë rekomanduar nëpërmjet agjencisë Further nga doktori(ët) ndërkombëtar që ka trajtuar Anëtarin e siguar, siç është e nevojshme për vazhdimin e trajtimit, mbulohen brenda një limiti 50 000 Euro për Anëtar të siguar.

Në rast se nevojiten ekzaminime paraprake ose konsulta me doktorët për procedurën ose operacionin e miratuar, a mbulohen këto ekzaminime ose konsulta?

Po, në rast se për këto është njoftuar siç duhet kompania e sigurimit dhe ato janë miratuar dhe shënuar përkatësisht në Certifikatën mjekësore paraprake të lëshuar nga Further gjatë procesit të kërkesës.

Çfarë ndodh nëse një Anëtar i siguar ka nevojë që të trajtohet më shumë se një herë në vit për një sëmundje të njëjtë ose të ndryshme që është e mbuluar? A mbulohen këto trajtime pasuese?

Po. Limitet vjetore të mbulimit llogariten në bazë të "viteve të sigurimit", duke i numëruar nga Data e fillimit të mbulimit të politikës dhe jo në bazë të viteve financiare apo kalendarike. Brenda këtyre limiteve vjetore të Politikës, nuk ka rëndësi nëse shpenzimet mjekësore janë në lidhje me sëmundje ose procedura mjekësore të njëjta apo të ndryshme të mbuluara, nëse këto trajtime janë miratuar dhe janë shënuar përkatësisht në Certifikatën mjekësore paraprake.

Nëse Anëtari i siguar nuk mund të udhëtojë jashtë shtetit të banimit/punësimit për shkak të gjendjes së tij/saj shëndetësore dhe ky fakt konfirmohet nga agjencia Further, a ka opsione të tjera për trajtimin e mbuluar nga Programi?

Jo. Nëse Anëtari i siguar nuk mund të udhëtojë jashtë shtetit të banimit/punësimit për të marrë trajtimin, ai/ajo nuk do të mund të marrë përfitimet e Programit.

Në rast se ndodh një komplikacion (që nuk mbulohet nga Programi) gjatë operacionit kirurgjikal (si pjesë e trajtimit të mbuluar), që duhet të trajtohet menjëherë me një procedurë që nuk mbulohet fillimisht sipas politikës, a do të mbulohet kjo procedurë?

Nëse, gjatë kryerjes së një operacioni kirurgjikal për një sëmundje ose procedurë mjekësore të mbuluar, shfaqen komplikacione që duhet të trajtohen në aspektin mjekësor, këto do të konsiderohen pjesë e procedurës mjekësore fillestare dhe për këtë arsye mbulohen nga Politika.

Because life matters most.

further



FAQJA 5

Programi i Kujdesit Shëndetësor Ndërkombëtar

A do ta ndihmojë dikush një Anëtar të siguar për përkthimin gjatë marrjes së trajtimit jashtë shtetit?

Po, Programi do të ofrojë mbështetje për përkthimin mjekësor kur jeni në spital. Sidoqoftë, ne nuk do të ofrojmë mbështetjen për përkthim ose për një interpret për nevoja që nuk kanë lidhje me ato mjekësore.

A ka ndonjë kufizim se kë mund të zgjedhë pacienti si shoqërues të tij/saj?

Jo. Sidoqoftë, rekomandohet shumë që të zgjidhni një shoqërues që mund të marrë vendime në emër të Anëtarit të siguar që merr trajtimin në rast se zhvillimi i rëndë i trajtimit nuk lejon që Anëtari i siguar t'i marrë këto vendime për veten e vet.

Në rast se një Anëtar i siguar ka nevojë për një transplant, a mbulohet dhuruesi nga limitet e udhëtimit dhe strehimit?

Po. Në rast se një Anëtar i siguar ka nevojë për një procedurë transplant, shpenzimet për udhëtimin dhe strehimin për dhuruesin do të mbulohen. Kini parasysht se shpenzimet e udhëtimit dhe strehimit për Anëtarin e siguar, shoqëruesin dhe dhuruesin do të mbulohen, por janë pjesë e limiteve të sigurimit të shumës totale sipas Politikës.

Because life matters most.

further



FAQJA 6

Because life matters most.
further



**International
Healthcare
Programme**

www.internationalhealthcareprogramme.com